

Dr. Arta Vorpsi është diplomuar juriste nga Fakulteti i Drejtësisë, Univeristeti i Tiranës, në vitin 1996. Në vitin 2001 ka përfunduar studimet pasuniversitare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Vjenës, Austri, me titullin: “Doktor i Shkencave Juridike (Dr.iur)”. Në vitet 2001-2020 ka punuar fillimisht si Drejtore e Studimeve dhe Botimeve dhe më pas si Këshilltare Ligjore e gjyqtarëve pranë Gjykatës Kushtetuese. Prej shtatorit 2020 punon si Drejtore e Kabinetit në Gjykatën e Lartë.

Është lektore e së drejtës kushtetuese dhe e të drejtave të njeriut në Fakultetin e Drejtësisë, si dhe në Shkollën e Magjistraturës. Angazhohet prej vitesh si eksperte për trajnimin e nëpunësve civilë, gjyqtarëve e prokurorëve, përgatitjen e studimeve dhe analizave ligjore, si dhe hartimin e projektligjeve dhe amendamenteve kushtetuese.

Është autore e librave: Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese (Tiranë, 2011), Recent developments on Albanian Constitutional Law (Regensburg, 2012), Limitations of National Sovereignty through European Integration (bashkëautore, Universiteti i Regensburgut, 2016), Ankimi Kushtetues Individual (bashkëautore, Tiranë/Shtutgart, 2017), Constitutional Justice and the Evolution of Human Rights (bashkëautore, Kishinau 2017), Rule of Law, Human Rights and Judicial Control of Power (bashkëautore, 2017), Handbook on Human Dignity in Europe (bashkëautore, Universiteti i Lucernes, 2019), Komentari mbi Reformën Kushtetuese në Sistemin e Drejtësisë (bashkëautore, Tiranë 2019), etj. Ka botuar mjaft artikuj brenda dhe jashtë vendit në fushën e së drejtës kushtetuese si dhe ka marrë pjesë si referuese në konferenca dhe seminare ndërkombëtare.

Është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të së Drejtës Kushtetuese, e Shoqatës Ndërkombëtare për të Drejtën Publike (IACL), e Konferencës Europiane për të Drejtën Kushtetuese të Krahasuar, si dhe anëtare e Shoqatës së Europës Juglindore me qendër në Munihi. Prej vitit 2015 është gjyqtare ad hoc pranë Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.